

0 RQVMP LL
6VMDMUNW
. RPE-VUHS-U
%DUJLQ
*NQRUH

2,



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



UNITED NATIONS
ALBANIA



Monitorim i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore

Bashkia Kamëz

VITI 2020

Ky raport është hartuar nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGJZH), në kuadrin e projektit *“Sigurimi i ekspertizës teknike për qeverinë dhe OSHC-të për zhvillimin, buxhetimin, zbatimin dhe monitorimin e masave për adresimin e dhunës ndaj grave në Strategjinë e re për Barazinë Gjinore dhe Planin e Veprimit”*. Projekti zbatohet në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara *“Për t’i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave”*, financuar nga Qeveria e Suedisë dhe që po zbatohet nga UNDP, UN Women dhe UNFPA, në bashkëpunim me Qeverinë e Shqipërisë

Përmbajtja e këtij manuali është vetëm përgjegjësi e Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim, dhe nuk reflekton opinionin e SIDA,UNDP, UNFPA dhe UN Women.

Tabela e Përmbajtjes

SHKURTIME	4
MONITORIMI I QËLLIMIT TË III-TË STRATEGJIK TË STRATEGJISË KOMBËTARE DHE PLANIT TË VEPRIMIT PËR BARAZI GJINORE 2016-2020	5
GJETJET KRYESORE	8
TË DHËNA STATISTIKORE NË LIDHJE ME RAPORTIMIN E DHUNËS NË FAMILJE NË BASHKINË KAMËZ	9
<i>Të dhëna nga Mekanizmi i Referimit, Bashkia Kamëz.....</i>	9
<i>Të dhëna nga Drejtoria Vendore e Policië për Bashkinë Kamëz</i>	11
<i>Të dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Bashkia Kamëz.....</i>	11
<i>Të dhëna nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Bashkia Kamëz</i>	12
REZULTATET E MONITORIMIT – VITI 2020	12
OBJEKTIVI 3.1 NDËRGJEGJËSIMI I SHOQËRISË PËR TË MOS PRANUAR DHE PËR TË MOS TOLERUAR USHTRIMIN E DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE.	12
OBJEKTIVI 3.2: FUQIZIMI I MEKANIZMAVE TË REFERIMIT SI DHE SHTIMI/PËRMIRËSIMI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE TË SPECIALIZUARA PËR MBROJTJEN DHE TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE.	15
OBJEKTIVI 3.3: NDËSHKIMI I DHUNUESVE DHE DHËNIA E MUNDËSISË PËR REHABILITIMIN E TYRE, PËRMES PROGRAMEVE TË SPECIALIZUARA.	19
<i>Konkluzione të rëndësishme.....</i>	<i>19</i>
<i>Rekomandime kryesore.....</i>	<i>20</i>

Shkurtime

ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BE	Bashkimi Evropian
BGj	Barazia Gjinore
DhBGj	Dhunë me bazë Gjinore
DhF	Dhunë në Familje
GTN	Grupi Teknik Ndërdisciplinor
INSTAT	Instituti i Statistikave në Shqipëri
KONVENTA CEDAW	Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
KONVENTA E STAMBOLLIT	Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
KD	Komiteti Drejtues
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
MShMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NBGj	Nëpunës i Barazisë Gjinore
NjVQV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
OShC	Organizatë e Shoqërisë Civile
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PKV	Plani Kombëtar i Veprimit
QAGjZh	Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim
QZhK "Sot për të Ardhmen"	Qendra për Zhvillim Komunitar "Sot për të Ardhmen"
REVALB	Sistemi elktornik (on-line) i regjistrimit të rasteve të dhunës në Shqipëri
RrFGSh	Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri
SKBGj	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore
ShGPS	Shoqata e Grave me Probleme Sociale, Durrës
UM	Urdhër Mbrojtje
UMM	Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtje
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UN WOMEN	Entitetet e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Hyrje

Ky raport u hartua në kuadër të Projektit "Sigurimi i ekspertizës teknike për qeverinë dhe OSHC-të për zhvillimin, buxhetimin, zbatimin dhe monitorimin e masave për adresimin e dhunës ndaj grave në Strategjinë e re për Barazinë Gjinore dhe Planin e Veprimit", në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara "Për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave", të financuar nga Qeveria e Suedia i cili po zbatohet nga UNDP, UN Women dhe UNFPA në partneritet me Qeverinë shqiptare. Në Shqipëri projekti u zbatua nga Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim", në bashkëpunim me disa organizata të tjera joqeveritare. Bashkitë e përfshira në monitorim ishin bashkitë e Lezhës, Kamzës, Fierit, Sarandës dhe Pogradecit.

Qëllimi i projektit është monitorimi i i detyrimeve ndërkombëtare dhe kombëtare të Shqipërisë për eliminimin e dhunës ndaj grave dhe të gjitha formave të diskriminimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare, ndërsa rezultati i pritur në terma afatgjatë është ulja e fenomenit të dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe të gjitha formave të tjera të diskriminimit në Shqipëri. Proçesi monitorues i SKBGj dhe PKV 2016-2020 për bashkitë e lartpërmenduar u zhvillua përgjatë periudhës Nëntor 2020 - Maj 2021. Aktivitetet në nivel qendror u monitoruan nga QAGjZh dhe në nivel lokal nga organizatat lokale, përmes mbledhjes së të dhënave zyrtare lidhur me zbatimin e Qëllimit Strategjik 3, të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planin e Veprimit 2016 – 2020.¹

Gjatë zbatimit të projektit u arrit që:

1. Të realizohej monitorimi i punës për t'i dhënë fund dhunës kundër grave dhe vajzave nëpërmjet mekanizmave të referimit si një mjet i cili identifikon arritjet dhe sfidat apo boshllëqet ekzistuese.
2. Organizatat partnere në projekt të rrisin kapacitetet për të monitoruar zbatimin e Objektivit të 3-të të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2016-2020;
3. U përdorën rezultatet nga monitorimi i fazës së parë për të kontribuar në përpilimin dhe implementimin e Strategjisë së re të Barazisë Gjinore duke filluar nga viti 2021.
4. U realizua procesi i promovimit dhe advokimit, për zbatimin e objektivit të 3-të të SKBGj 2016-2020, duke përdorur gjetjet dhe rekomandimet e proceseve monitoruese.

Ky projekt, e nisi punën me organizimin e seancave informuese me përfaqësuesit e organizatave partnere në 5 Bashkitë nën monitorim, bazuar në udhëzuesin për monitorimin e Qëllimit Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020, të realizuar nga GADC, në Nëntor 2019 dhe të rishikuar në fillim të vitit 2020. Përveç manualit, u hartuan skedat monitoruese bazuar në indikatorët për monitorimin e zbatimit të Qëllimit Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020, të cilat u përdorën gjatë procesit të monitorimit.

Rreth organizatave zbatuese

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGjZh) është një organizatë jo-fitimprurëse shqiptare që vepron dhe punon në të gjithë Shqipërinë për fuqizimin e grave dhe për të krijuar një të ardhme të barabartë dhe të drejtë për vajzat dhe gratë me të ardhura të ulëta në të gjithë Shqipërinë, duke u përpjekur për t'i nxjerrë nga varfëria dhe përjashtimi. Për të mbrojtur të drejtat e grave dhe për t'i fuqizuar ato, QAGjZh ngre fonde kombëtare dhe ndërkombëtare.

Fushat kryesore të ekspertizës së QAGjZh-së janë:

¹ <https://www.un.org.al/sites/default/files/SKGJB-AL-web.pdf>

- Promovimi i paqes dhe përpjekjet për t'i dhënë fund dhunës me bazë gjinore;
- Garantimi i fuqizimit ekonomik të grave;
- Sipërmarrjet e grave;
- Fuqizimi i qytetarëve për të monitoruar agjendën gjinore lokale;
- Rritja e përfaqësimit të grave në politikë dhe vendimmarrje;
- Përmirësimi i të drejtave të grave në zona rurale.

Gjatë procesit të monitorimit të bashkive Fier, Lezhë, Pogradec, Sarandë dhe Kamëz, QAGJZh bashkëpunoi me disa organizata të tjera të cilat veprojnë në territorin e bashkive nën monitorim si: Qendra Rinore Vlorë, Epoka e Re Fier, Tjetër Vizion Elbasan dhe Shoqata për Integrimin e Zonave Informale Kamëz.

Përse monitorim i SKBGj-së nga OShC-të?

Përgjegjshmëria në qeverisje është një element i rëndësishëm që përcakton marrëdhëniet midis atyre që ushtrojnë fuqinë e pushtetit dhe atyre në emër të të cilëve ushtrohet kjo fuqi. Në sistemet demokratike, fuqizimi i sistemeve të transparencës dhe përgjegjshmërisë është prioritet i vazhdueshëm, që sigurohet përmes mekanizmave të ndërtuar, që përmirësohen vazhdimisht e që garantojnë pjesëmarrjen aktive në vendimmarrjen publike të shoqërisë civile, OShC-ve apo vetë përfaqësuesve të komuniteteve lokale. Këto mekanizma forcojnë proceset demokratike, sigurojnë zhvillim efektiv përmes dhënies së shërbimeve efektive, lehtësojnë procesin e mirëqeverisjes dhe fuqizojnë grupet më vulnerabël të komuniteteve, siç janë vajzat e gratë viktimat të dhunës në familje.

Ndërkohë që ligjet dhe strategjitë kombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e vajzave e grave dhe dhunën në familje/ me bazë gjinore janë hartuar me kontributin e vyer e të pakursyer të OShC-ve të grave, deri tani kjo rutinë nuk është shoqëruar me procese monitoruese e vlerësuese nga vetë OShC-të. Organizatat e grave në Shqipëri kanë të gjitha kapacitetet e nevojshme për të monitoruar dhe vlerësuar strategjitë dhe planet e veprimit në fushën që ato punojnë çdo ditë. Mbi të gjitha, ato për shumë vite kanë luajtur një rol vendimtar në adresimin e dhunës ndaj grave nëpërmjet ofrimit të shërbimeve, rritjes së ndërgjegjësimit, ngritjes së kapaciteteve, lobimit dhe advokimit, duke u bërë kështu aktorë kyç në nivel vendor e kombëtar.

OShC-të janë shumë të interesuara që të monitorojnë strategjinë kombëtare dhe planin e veprimit, në mënyrë që të ketë një të kuptuar më të mirë të asaj që qeveria po bën në këtë drejtim. Qëllimi përfundimtar është, zbatimi i një procesi monitorimi të paanshëm që do të sigurojë një zbatim më të mirë të hapave të ardhshëm që do ndërmerren për reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe avancimin e barazisë gjinore në shoqëri. Vlen të theksohet se, Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale (MShMS), e ka mirëpritur këtë nismë dhe ka theksuar se ky monitorim nga shoqëria civile do të shërbejë për të informuar edhe procesin e monitorimit të brendshëm të SKBGj 2016-2020 nga institucionet përgjegjëse.

Metodologjia

Për të kryer monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore 2016-2020 dhe Planit të Veprimit, u ndoq një qasje e dyfishtë metodologjike në mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore. Një eksperte lokale u përzgjedh për çdo Bashki të targetuar, me qëllim ndjekjen e punës së Bashkisë përkatëse dhe mbledhjen e të dhënave për periudhën Janar – Dhjetor 2019. Procesin e mbledhjes së të dhënave është kryer si më poshtë vijon:

- Mbledhja e të dhënave përmes takimeve informuese me zyrtarë lokal e publikë. Faza e parë ishte kontakti me kryetarët e Bashkive të targetuara, për njoftimin e tyre mbi iniciativën e monitorimit. Më pas, monitorueset kontaktuan përmes një formati të njësuar, koordinatorin vendor të dhunës pranë Bashkisë dhe kurdo që ishte e mundur me drejtorinë e shërbimeve sociale, drejtorinë e shëndetit, organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në territorin e bashkisë, zyrtarët e gjykatave të rrethit, komunitetet fetare, mediat, organizatat ndërkombëtare dhe aktorë të tjerë të përfshirë në luftën kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Qëllimi i këtyre takimeve ishte vendosja e kontaktit që më pas u ndoq me kërkesa për informacion, të dhëna statistikore dhe të dhëna të tjera mbi punën e kryer nga Bashkia dhe institucione të tjera, për adresimin e objektivit të tretë të SKBGj për eliminimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Monitorueset gjithashtu kanë ndjekur takimet e zhvilluara në kuadër të mekanizmit të referimit në Bashki dhe kanë raportuar mbi përmbajtjen e tyre dhe vendimet e marra.
- Mbledhja e të dhënave përmes burimeve zyrtare e statistikore. Përmes të drejtës për informim, monitorueset kanë kërkuar të gjithë dokumentet mbështetëse të punës së bashkisë në kuadër të luftës kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Specifikisht:
 - Janë mbledhur minutat mbi takimet e mekanizmit të referimit për çdo bashki, që kanë plotësuar informacionet e ndara me monitorueset përmes intervistave.
 - Janë marrë të dhëna statistikore mbi prevalencën e dhunës në familje nga gjykatat, shërbimi i provës, bashkia, policia, shërbimi social dhe INSTAT.
 - Është analizuar buxheti vjetor i bashkisë për të identifikuar burimet financiare të alokuara për zbatimin e SKBGj në luftën kundër dhunës në familje.
 - Janë mbledhur materiale mbështetëse për aktivitetet ndërgjegjësuese të zhvilluara nga ana e bashkisë për përmbushjen e objektivit 3.1.

Raporti i monitorimit ndjek strukturën e objektivave specifike të SKBGj sa i përket dhunës me bazë gjinore si edhe aktivitetet specifike të planit të veprimit. Për këtë është hartuar një skedë monitoruese e cila është plotësuar në vijimësi nga monitorueset përmes informacionit të akumuluar përgjatë periudhës monitoruese.

Bazuar tek skeda monitoruese është bërë vlerësim i përmbushjes së angazhimeve të bashkive të targetuara nën objektivin e tretë të SKBGj duke identifikuar nga njëra anë praktikat pozitive prej të cilave mund të përfitojnë edhe bashki të tjera dhe nga ana tjetër sfidat dhe mangësitë me të cilat përballen bashkitë, për të identifikuar mundësitë për përmirësim në periudhën e mbetur të planit të veprimit të SKBGj.

Për të kryer monitorimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore janë përdorur edhe të dhënat e sistemit REVALB. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me mbështetjen e UNDP ka hartuar dhe miratuar bazën e nevojshme ligjore për funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Bashkërendimit të Punës dhe Referimit të rasteve të dhunës në familje në mënyrë që të parandalohen, raportohen dhe trajtohen me efektivitet rastet e dhunës në familje.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 334, dt 17.02.2011 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij" përcakton midis të tjerave dhe detyrimet konkrete të institucioneve shtetërore përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave, raportimin dhe referimin e rasteve të dhunës në familje. Sistemi online në lidhje me statistikën për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje në nivel bashkie është lançuar në vitin 2014. Ky sistem online regjistron çdo rast dhune, monitoron si po ecën referimi i rastit dhe ku ka ngecur ai, duke siguruar që t'i shkojë deri në fund çdo rasti të raportuar të dhunës në marrëdhëniet familjare. Sistemi online është i sigurt dhe respekton fshehtësinë e të

mbijetuarave të dhunës. Ai përdoret nga një numër i kufizuar i nëpunësve vendorë dhe qendrorë, të cilët janë trajnuar posaçërisht për përgjigjen ndaj dhunës në familje, fshehtësinë e të dhënave të së mbijetuarës dhe për përdorimin e sistemit. Ky sistem aksesohet nga të gjitha bashkitë në nivel lokal dhe MShMS në nivel qendror në adresën www.revalb.org

Mbi bazën e të dhënave të hedhura, sistemi prodhon raporte interaktive dhe të mundshme për t'u printuar në kohë reale të cilat kontribuojnë në: hartimin e politikave; matjen e efektivitetit të Grupeve Teknike Ndërdisciplinore (GTN) të ngritura në nivel lokal; përmirësimin e të dhënave statistikore të rasteve të dhunës në familje në nivel lokal; në marrjen e masave për mirë-funksionimin e mekanizmit referues në të gjitha njësitë vendore; Kryerjen e analizave statistikore, për të identifikuar probleme si dhe fusha ku ka nevojë për ndërhyrje; për të shmangur të gjitha dyshimet për të dhënat e pavërteta ose shifrat e gabuara, që çojnë në rritjen e besimit dhe përmirësimin e shkallës së bashkëpunimit midis aktorëve dhe të atyre që përfitojnë prej saj.

Monitorimi i Qëllimit të III-të Strategjik të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020

Informacioni më poshtë i referohet gjetjeve të monitorimit të zbatimit të Strategjisë gjatë vitit 2020.

Gjetjet kryesore

- Pranë Drejtorisë Vendore të Policisë në Bashkinë Kamëz, për vitin 2020 janë evidentuar 317 raste të viktimitave të dhunës në familje, ku 248 prej tyre ishin gra dhe vajza.
- 2 ishin rastet kur viktimat e dhunës në familje u vranë nga bashkëshortët.
- Mekanizmi i Koordinuar i Referimit ka menaxhuar përgjatë vitit 2020 rreth 89 raste të viktimitave të dhunës në familje, prej të cilave rreth 20 raste klasifikohen si raste suksesi.
- Gjatë vitit 2020 janë 120 raste për të cilat janë lëshuar Urdhrat e Mbrojtjes (UM) dhe Urdhrat e Menjëhershëm të Mbrojtjes (UMM) nga gjykata për Bashkinë e Kamzës.
- Gjatë vitit 2020, Mekanizmi i Koordinuar i Referimit pranë kësaj Bashkie, nën koordinimin e Koordinatorës Vendore kundër Dhunës, ka organizuar 6 aktivitete për ndërgjegjësimin e qytetarëve për të mos e pranuar dhe për ta denoncuar dhunën e çdo lloj forme. Grupet e përfshira në këto aktivitete janë gra dhe vajza, të mbijetuara të dhunës në familje.
- Bashkia Kamëz ka firmosur të dy protokollet e reja të dala nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale sa i përket menaxhimit të viktimitave të dhunës në familje në kohë pandemie. Specifikisht, protokollin e menaxhimit të rasteve të dhunës në familje në nivel vendor, përmes mekanizmit të koordinuar të referimit (MKR) në kohë normale si edhe të njëjtin protokoll gjatë situatës së Covid-19. Megjithëse këto protokolle qarkulluan dhe hynë në fuqi që në fund të muajit Prill 2020, Komiteti Drejtues pranë kësaj Bashkie i firmosi ato në datë 2.12.2020.
- Gjatë vitit 2020 Ekipi Teknik Ndërdisciplinar ka organizuar gjithsej 5 mbledhje me anëtarët e ekipit, por takimet ad-hoc dhe online kanë qenë të vazhdueshme dhe periodike për çdo trajtim apo menaxhim rasti të dhunës në familje.
- Komiteti Drejtues i kësaj Bashkie arriti të mblidhej vetëm një herë përgjatë vitit 2020.
- Sipas monitorimit dhe informacioni të përfituar asnjë grua, viktimë e dhunës në familje nuk ka përfituar bonus qeraje përgjatë vitit 2020.

- Që prej muajit Tetor 2020, pranë Sektorit të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Barazisë Gjinore në Bashkinë Kamëz, janë shtuar edhe 4 punonjëse të reja të cilat merren edhe me menaxhimin e rasteve të dhunës në familje një Njësitë përkatëse Administrative pranë kësaj Bashkie.
- Nuk ka një shifër të saktë sa i përket punësimit të grave dhe vajzave, viktimat e dhunës në familje. Sipas takimeve dhe hulumtimeve, viktimat e dhunës në familje nuk pranojnë të punojnë në fasoneri apo punë të tilla që kërkojnë shumë orë larg shtëpisë apo edhe lodhje fizike të madhe.
- Për shkak të situatës së pandemisë, mbledhjet e MKR nuk janë zhvilluar rregullisht.
- Janë gjetur vështirësi në menaxhimin e rasteve të dhunës dhe adresimin e nevojave të tyre për shkak të shërbimeve të limituara në dispozicion.
- Janë gjetur vështirësi në monitorimin e rasteve të pajisura me UMM/UM nga ana e Policisë.
- Koordinatorja vendore ka hasur vështirësi në plotësimin në mënyrë të rregull të rasteve në sistemin REVALB.

Të dhëna statistikore në lidhje me raportimin e dhunës në familje në Bashkinë Kamëz

Të dhëna nga Mekanizmi i Referimit, Bashkia Kamëz

Mekanizmi i Koordinuar i Referimit ka menaxhuar përgjatë vitit 2020 rreth 89 raste prej të cilave rreth 20 raste klasifikohen si raste suksesi, të cilat kanë marrë shërbime të plota dhe janë menaxhuar në mënyrë të vazhdueshme për t'u integruar. Disa prej rasteve paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Tabela 1. Raste të suksesshme të trajtuara nga Mekanizmi i Referimit, Bashkia Kamëz

Rasti	Trajtimi
Znj.Sh.P	<p>Viktimë e dhunës sistematike fizike dhe psikologjike të ushtruar nga bashkëjetuesi i saj. Nënë e një fëmije të mitur përkatësisht 8 vjeçe. Fëmija ka qënë pjesë e skenave të dhunës.</p> <p>Komisariati i Policisë nr.5 Kamëz i asistuar nga Koordinatorja Vendore Kundër Dhunës në Familje vlerësoi riskun dhe mbështeti Sh.P. me përgatitjen e kërkesës për lëshimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes. Pas shqyrtimit të rastit, është arritur në përfundimin se ka rrezikshmëri mesatare dhe menjëherë është plotësuar kërkesë padia dhe është lëshuar urdhër i menjëhershëm mbrojtje nga gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë.</p> <p>Viktima së bashku me fëmijën u zhvendosën përkohësisht tek gjyshërit derisa gjykata e Tiranës aprovoi kërkesë padinë. Në këtë rast vajza dhe nëna ishin me fat pasi kishin</p>

	<p>mbështetjen e familjarëve në çdo vendim të marrë nga ana e tyre. Në bashkëpunim me policinë në Kamëz u bë i mundur shoqërimi i nënës, fillimisht në banesën e tyre për marrjen e sendeve personale dhe më pas për në banesën e prindërve.</p> <p>Ndihma juridike dytësore iu ofrua rastit në çështjen me objekt „lëshimin e UMM & vërtetimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes dhe lëshimin e Urdhrit të Mbrojtjes“.</p> <p>Falë bashkëpunimit me Zyrën Arsimore Kamëz u bë e mundur zhvendosja e vajzës së mitur nga shkolla në Fushkrujë për t’u vendosur në një shkollë më afër banesës së gjyshërve. Fëmija u mbështet me asistencë psikologjike për të tejkaluar rëndesën psikologjike të shkaktuar nga dhuna në familje si dhe me paketa ushqimore - nga Bashkia dhe OSHC gjatë kohës së pandemisë.</p> <p>Pas largimit nga banesa e prindërve zonja u vendos në një banesë me qera e cila u ndihmua nga Organizata Nisma për pagesën e qerasë. U konfirmua UMPMM dhe u lëshua UM nga GjRrGj Tiranë.</p>
<p>Znj.B.N</p>	<p>Është paraqitur pranë komisaritit të policisë nr.5 Kamëz për të kërkuar ndihmë pasi dhunohej nga bashkëshorti në mënyrë psikologjike edhe pas rikthimit të saj nga Franca. Historia e dhunës kishte nisur prej 1 viti ku bashkëshorti e kishte dhunuar fizikisht edhe pas rikthimit.</p> <p>Ajo shprehet se ka 9 vite e martuar dhe ka 2 fëmijë të mitur. Komisarati i Policisë nr.5 Kamëz i asistuar nga Koordinatorja Vendore Kundër Dhunës në Familje vlerësoi riskun dhe mbështeti B.N. me përgatitjen e kërkesës për lëshimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes. Pas shqyrtimit të rastit menjëherë është plotësuar kërkesë padia dhe është lëshuar urdhër i menjëhershëm mbrojtje nga gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë.</p> <p>Pas dhënies së deklaratës së saj në polici dhe marrjes së masave paraprake të mbrojtjes së menjëhershme nga dhuna në familje, Zj.B.N. akomodohet në Qendra Kombëtare për Viktimave e Dhunës në Familje në Kamëz. Rasti nuk ka qëndruar më shumë se një natë ndërkohë që</p>

	<p>është marrë nga prindërit e saj.</p> <p>Falë bashkëpunimit me Zyrën e Punës rasti arriti të punësohet menjëherë në një fasoneri. U konfirmua UMPMM dhe u lëshua UM nga GjRrGj Tiranë.</p>

Burimi: Koordinatorja Vendore, Bashkia Kamëz

Të dhëna nga Drejtoria Vendore e Policisë për Bashkinë Kamëz

Sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pranë Policisë Vendore, bashkia Kamëz, për vitin 2020 janë evidentuar 317 raste të dhunës në familje nga të cilat 248 ishin gra dhe vajza. Në 192 raste u plotësuan kërkesat për Urdhër të Mbrojtjes dhe në 9 raste u sinjalizua dhe u evidentua shkelja e Urdhrit të Mbrojtjes (UM). Ndërkohë po gjatë këtij viti Kamza shënoi 2 viktima të cilat humbën jetën si pasojë e vrasjes nga dhunuesi. Nuk ka një informacion të mirëfilltë nëse pas ndryshime të fundit në ligjin “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënie familjare” të jetë implementuar edhe nxjerrja e dhunuesve nga banesa.

Tabela 2. Dhuna në familje në Drejtorinë Vendore të Bashkisë Kamëz

Përshkrimi	Komisariati –Bashkia Kamëz
Evidentuar	317
Të dëmtuar gjithsej	317
Prej tyre gra/vajza	248
K-P.U. Mbrojtje	192
Sh.U. Mbrojtjes	9
V. P. Neni 130/a	102
Vrasje raste/viktima	2/2
Arrest. për 130/a	36
Ndaluar për 130/a	8
Gjendje të Lirë për 130/a	47
Në kërkim për 130/a	11
Autorë të vetëvrarë	0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Të dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Bashkia Kamëz

Sipas të dhënave të përfituara nga gjykata për bashkinë e Kamzës, për vitin 2020 evidentohen 120 raste të dhunës në familje, të cilat kanë përfutur Urdhër Mbrojtje dhe Urdhër të Menjëhershëm të Mbrojtjes.

Të dhëna nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Bashkia Kamëz

Përgjatë vitit 2020 u evidentuan 102 Vepra Penale të „Dhunës në familje“ sipas nenit 130/a, ku u arrestuan 36 prej tyre, 8 u ndaluan. Ndërkohë që 47 janë agresorët të cilët gjatë vitit 2020 u ndoqën në gjendje të lirë dhe 11 të tjerë janë në kërkim nga policia e shtetit.

Rezultatet e Monitorimit – Viti 2020

Objekti 3.1 Ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Mekanizmi i Referimit pranë Bashkisë Kamëz ka për detyrë ndjekjen e rastit dhe plotësimin e nevojave të viktimës së dhunës në familje duke siguruar edhe adresimin në shërbimet e përshtatshme; koordinimi dhe mbikëqyrja e ofrimit të shërbimeve; menaxhimi i rasteve të dhunës; shkëmbimi i të dhënave të rasteve konkrete ndërmjet institucioneve; monitorimi i mënyrës së funksionimit të të gjithë sistemit si dhe raportimi në institucionet eprorë. Institucionet përgjegjëse për funksionimin e Mekanizmit të Referimit janë: Bashkia, e cila luan rol drejtues në ngritjen, konsolidimin, monitorimin dhe vazhdimësinë e mekanizmit të referimit të rasteve të dhunës; komisarati i policisë, qendrat shëndetësore, Qendra Kombëtare e Trajtimin të Viktimave të Dhunës në Familje, zyra e Ndhmës Ekonomike, zyra vendore e Punësimit, drejtoritë arsimore, organizatat jofitimprurëse.

Bashkia në bashkëpunim me Qendrën “Të Drejtat e Njeriut në Demokraci” (QDNJD) ka organizuar disa takime në terren me fokus-grupe vajza dhe gra për ndërgjegjësimin e tyre për të mos toleruar asnjë formë dhune. Bashkia Kamëz, në datë 04.04.2020 ka realizuar aktivitetet për të rritur ndërgjegjësimin mbi dhunën në familje gjatë periudhës së izolimit nga COVID-19, në të cilën u zhvillua një fushatë informimi në mediat sociale për shërbimet që ofrohen në rast nevojë, në bashkëpunim me USAID.

QDNJD në muajin Maj 2020 ka nisur zbatimin projektin *“Fuqizimi i reagimit të koordinuar të ofruesve të shërbimeve (struktura të policisë, shëndetësisë, arsimit dhe sektorët e qeverisjes vendore për të menaxhuar çështjet që lidhen me të gjitha format e dhunës ndaj grave në përputhje me standartet e CEDAË dhe Konventës së Stambollit”*, projekt ky që financohet nga Komisioni Europian dhe zbatohet nga UN Women Albania. Ky projekt po zbatohet në Bashkinë Kamëz, Bashkinë Vorë dhe në Njësinë Administrative Fushë-Krujë. QDNJD ka kontribuar në ndërgjegjësimin e institucioneve shtetërore dhe komunitetit për dhunën ndaj grave dhe vajzave dhe dhunën në familje. Gjithashtu ka kontribuar tek anëtarët e MKR pranë kësaj bashkie në ngritjen e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve publike me qëllim ofrimin e shërbimeve të përshtatshme dhe cilësore për gratë viktime të dhunës dhe dhunës në familje. Paralelisht ka ndihmuar në rritjen e njohurive të komunitetit mbi legjislacionin mbi dhunën kundër grave dhe mjetet ligjore për mbrojtje si edhe shërbimet ekzistuese.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2020 Bashkia Kamëz ka zhvilluar 5 takime koordinuese me anëtarët e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit për trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Gjatë takimeve të Mekanizmit diskutohen problematikat e çdo rasti konkret, shërbimet e marra nga Bashkia dhe anëtarët e MKR si dhe nevojat në vazhdim të secilit rast.

QDNJD, është pjesë aktive e këtij Mekanizmi dhe ofron ndihmë ligjore (këshillim ligjor dhe përfaqësim falas në gjykatë) ofron mbështetje psiko-emocionale, asiston nëpërmjet përgatitjes së dokumentacionit ligjor dhe ndërmjetëson me strukturat përgjegjëse në funksion të adresimit të nevojave të tyre etj.

Gjatë mbledhjeve të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit janë trajtuar 50 raste të dhunës në familje të referuara nga Komisariati nr.5. Nga rastet e trajtuara në MKR, 27 raste janë këshilluar individualisht për çështje të dhunës në familje dhe çështje të tjera civile dhe 9 prej këtyre rasteve janë përfaqësuar në Gjykatë dhe janë pajisur me Urdhër Mbrojtje.

Koordinatorja vendore kundër dhunës në familje dhe Punonjësja për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF) në Bashkinë Kamëz në shumë raste asistohet nga përfaqësuesi i QDNJD në trajtimin e rastit në komisarjat. Ky bashkëpunim realizohet në mënyrë të veçantë në rastet kur viktimat paraqet shenja të dhunës fizike dhe është i nevojshëm shoqërimi pranë Qendrës Shëndetësore për trajtim mjekësor dhe pajisje me raportin e posaçëm mjekësor, i cili shërben si provë shumë e rëndësishme në procesin gjyqësor civil për lëshimin e UMM/UM. Në disa raste koordinatorja vendore dhe PMF-në kanë bashkisë Kamëz kanë përfaqësuar rastet në Gjykatë me mbështetjen e QDNJD.

Në Korrik të vitit 2020 pranë Njësive Administrative/lagjeve në varësi të Bashkisë Kamëz, përkatësisht (Bathore, Paskuqan, Laknas, Frutikulturë) është shtuar struktura e punonjësve për mbrojtjen e fëmijëve të cilët mbulojnë edhe çështjet e barazisë gjinore dhe dhunës në familje. Shtimi i numrit të punonjësve pranë këtyre njësive është shumë i rëndësishëm dhe lidhet drejtpërdrejt me respektimin e njerëzimit prej parimeve kryesore të Ligjit nr. 9669 "*Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*", i ndryshuar, që ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve për viktimën sa më afër vendbanimit apo vendqendrimin të saj. Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim ka ndihmuar në ngritjen e kapaciteteve të këtyre punonjësve në funksion të ofrimit të një shërbimi sa më efikas dhe cilësor për të mbijetuarat nga dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore, bazuar në protokollet e miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Gjatë vitit 2020 Bashkia Kamëz ka organizuar gjithsej 6 aktivitete pa shpenzuar asnjë buxhet duke qenë se nuk ka të parashikuar një zë të tillë për organizimin e aktiviteteve ndërgjegjëse. Në këto aktivitete u përfshinë gra, të mbijetuara të dhunës në familje. Aktivitetet mbështeten në shumicën e rasteve nga organizatat e shoqërisë civile që operojnë në territorin e kësaj bashkie.

Paralelisht, janë realizuar disa aktivitete nga OSHC në territorin e Bashkisë Kamëz ku në fokus grup të tyre kanë qënë grupet vulnerable si viktimat e dhunës në familje, familjet në Ndihmë Ekonomike etj. Përveç grupeve vulnerable pjesë e trajnimeve kanë qënë dhe punonjësit e bashkisë si nga strehimi, financa, statistikat, arsimit dhe zyra e ndihmës ekonomike dhe çështjet sociale.

Organizatata që kanë dhënë këto trajnime janë USAID, World Vizion, QDNJD, Aleanca Gjinore për Zhvillim.

Bashkia Kamëz ka marrëveshje bashkepunimi me World Vizion, Global Care dhe QDNJD.

Disa prej punonjësve të bashkisë kanë marrë trajnim në lidhje me buxhetimin gjinor. Përfaqësuesit kryesor përveç drejtorisë së çështjeve sociale, ishin nga drejtoria e financave, statistikave dhe arsimit. Ka patur trajnime të përbashkëta me anëtare të mekanizmit kryesisht këto trajnime janë zhvilluar me Qendën “Të Drejtat e Njeriut në Demokraci”;

Pranë kësaj bashkie vijon të mungojë bashkëpunimi apo koordinimi me organizata me bazë fetare për trajnime apo organizim aktiviteteve të përbashkëta sa i përket dhunës me bazë gjinore.

Tabela 3. Tabela e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore dhe datat e realizimit të tyre

Nr.	Data	Vendi	Tema	Organizuar nga:
	04.04.2020	Online, shpërndare në rrjetet sociale	Aktivitet për të rritur ndërgjegjesimin për dhunë në familje gjatë periudhës së izolimit në të cilën u zhvillua një fushatë informimi në mediat sociale për shërbimet që ofrohen në rast në nevojë në bashkepunim me USAID.	USAID ne bashkëpunim me Bashkinë Kamëz
	07.09.2020	Tiranë	Ndryshimi i mendësive të burrave dhe djemve dhe raportimi i dhunës në familje në bashkepunim me Observatorin ku mesazhi është përcjelle nga vetë fëmijet.	Observatori
	15.08.2020	Pallati i Kultures, Bashkia Kamëz	Sesione informuese me anëtarët e GTN në bashkepunim me organizatën Të ndryshëm të barabartë kundër dhunës në familje dhe mënyrën e menaxhimit të rasteve.	Bashkia Kamëz
	27.08.2020	Shkolla “Azem Hajdari “	Aktivitete me nxenesit e shkolles "Azem Jashari" në kuader të javës kundër trafikimit në bashkepunim me organizatën Të ndryshëm të barabarte.	Bashkia Kamëz
	05.11.2020	Kamëz pranë zyrës së QDNJD	Zëri i grave në prioritetet e buxheteve të bashkive	QDNJD në bashkëpunim me Bashkinë Kamëz

25.11.2020	Bashkia Kamëz	Aktivitet ndërgjegjesues ku në fokus ishte shpërndarja e fletpalosjeve informuese/ndërgjegjësuese në hapësirat publike, të qytetarët, me mesazhe kundër fenomenit të dhunës dhe mënyrën e raportimit të saj në bashkëpunim me QDNJD dhe anëtarët e mekanizmit	Bashkia Kamëz
03.12.2020	Pallat Kulture	Njohja e të drejtave fuqia jonë	Bashkia Kamëz

Burimi: Monitorim dhe Koordinatorja Vendore, Bashkia Kamëz

Objektivi 3.2: Fuqizimi i mekanizmave të referimit si dhe shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Mekanizmi i Koordinuar i Referimit pranë kësaj Bashkie nuk është mbledhur rregullisht ëdo muaj gjatë vitit 2020. Në total 5 ishin mbledhjet e Ekipit Teknik Ndërdisciplinar, por që në mënyrë të rregullt ka vijuar komunikim online ose takime ad-hoc me anëtarë të ndryshëm të ekipit teknik ndërdisciplinar sipas nevojave dhe kërkesave të viktimës së dhunës të trajtuar nga MKR. Gjatë vitit 2020, MKR pranë kësaj bashkie ka trajtuar dhe menaxhuar nën koordinimin e koordinatores vendore kundër dhunës 89 raste të viktimave të dhunës në familje. Rastet janë trajtuar bazuar në nevojat specifike për secilin rast.

Pas cdo mbledhje të mekanizmit të referimit kordinatoria e dhunës në familje ndan me anëtarët e mekanizmit informacione dhe minutat e takimit, si është vepruar me secilin rast si dhe shërbimet që kanë marrë dhe nevojat në vazhdim duke ju lënë detyrë secilit insitucion përgjegjës.

Ndërkohë që sa i përket sistemit REVALB ai përdoret në mënyrë të rregullt, njëkohësisht edhe me sistemin SHKSH (Sistemi Kombëtar i Shërbimeve Shoqërore). Por, sipas monitorimit dhe informacionit të përfituar nga kordinatorja vendore kundër dhunës, plotësimi i të dy sistemeve kërkon kohë dhe angazhim të mirëfilltë dhe kjo i vështirëson punën e përditshme dhe shpesh ka edhe vonesa në plotësimin e këtyre sistemeve.

Bashkia Kamëz nuk ka asnjë buxhet të dedikuar në zërat e saj sa i përket ndërgjegjesimit të komunitetit për të mos pranuar dhunën apo për ta denoncuar atë. Buxheti mbulon vetëm pagat e punonjësve. Në këtë kuadër, përgjatë vitit 2020 asnjë grua, viktimë e dhunës në familje nuk ka përfituar bonus qeraje.

Përsa i përket ngritjes së kapaciteteve të koordinatores kundër dhunës pranë Bashkisë Kamëz, janë ndërmarrë disa trajnime apo edhe workshope përgjatë vitit 2020. Pandemia COVID-19 solli edhe mundësi të reja për të rritur kapacitetet me anë të trajnimeve online.

- Trajnim “Dhuna në familje dhe roli i autoriteteve përgjegjëse “ (MSHMS)
- Trajnim për protokollin e anëtarëve të MKR-ve për menaxhimin e rasteve të DHF dhe për situatën Covid - 19. (MSHMS)
- Trajnim lidhur me procedurat standarte të veprimit për DHF dhe DHBGJ online. (MSHMS)
- Takim për diskutim mbi përgatitjen e një dokumenti për dhunën seksuale (MSHMS)
- Trajnim për treguesit social dhe shërbimet e kujdesit shoqëror (MSHMS)
- Trajnim në distance për sistemin elektronik REVALB (MSHMS)
- Takim online për PV Rezolutën 1325 (MSHMS)
- Takim online “Për fuqizimin e rrjetit të KVDH. “(MSHMS)
- Ri-integrimi I të rikthyerve nga emigracioni dhe investimi për ta në Shqipëri. (World Vision)
- Akademia Multidisiplinare të profesionistëve për mbrojtjen e femijëve dhe të rinjve nga dhuna dhe shfrytëzimi seksual. (CRCA)
- Trajnim mbi Statistikat Gjinore dhe përpunimin e tyre, kjo për të fuqizuar koordinatorët vendore të MKR-ve (Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim).
- Trajnim për rritjen e kapaciteteve të njohurive dixhitale (Qendra Aleanca Gjinore për zhvillim)
- Trajnim mbi implementimin e protokollit për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje në kohë pandemie. (Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim).

Bashkia Kamëz ka firmosur të dy protokollin e reja të dala nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale sa i përket menaxhimit të viktimave të dhunës në familje në kohë pandemie. Specifikisht, protokollin e menaxhimit të rasteve të dhunës në familje në nivel vendor, përmes mekanizmit të koordinuar të referimit (MKR) në kohë normale si edhe të njëjtin protokoll gjatë situatës së Covid-19. Megjithatë këto protokolle qarkulluan dhe hynë në fuqi që në fund të muajit prill 2020, Komiteti Drejtues pranë kësaj bashkie i firmosi ato në mbledhjen e vetme të organizuar në datë 2.12.2020.

Nuk ka asnjë grua apo vajzë viktimë të dhunës në familje që të jetë punësuar me ndërmjetësimin e Zyrës së Punës pranë kësaj bashkie. Sipas informacioneve të marra, janë zakonisht ky target grup të cilat refuzojnë punët e ofruara dhe përfitojnë që të marrin vetëm ndihmën prej 3000 lekësh që përfitojnë nga UM dhe pako të tjera ushqimore apo veshëmbathje dhe kite higjienike që ofron bashkia apo organizata bamirëse të shoqërisë civile që operojnë në terren. Sidoqoftë, nuk ka asnjë statistikë të saktë dhe zyrtare nga Zyra e Punës sa i përket numrit të kërkesave apo të ofertave për punë që i janë ofruar viktimave të dhunës në familje.

Sa i përket bashkëpunimit mes anëtarëve të MKR pranë kësaj bashkie, vihet re një bashkëpunim i mirë mes tyre. Anëtarët e MKR-së së kësaj Bashkie janë pothuajse të gjithë të pranishëm në mbledhjet e Ekipit Teknik Ndërdisciplinar, përveç përfaqësuesve të Gjykatës, Prokurorisë dhe Zyrës së Punës. Ndërkohë që, Komisariati i Policisë në Kamëz është pika e parë ku viktimat drejtohen për të kërkuar ndihmë. Dhe është pikërisht komisarati nr. 5 i cili plotëson kërkesat për UM, dhe përgjatë vitit 2020 nuk ka asnjë UM të plotësuar nga Bashkia Kamëz.

Rast specifik

Një nga rastet e evidentuara të dhunës në familje është edhe zonja M.Q, nënë e një fëmije 2 vjeçar. Zonja është dhunuar psikologjikisht në mënyrë sistematike nga bashkëshorti. Familja jetonte në zonën e Kamzës. Gjatë asistimit në ambjentet e komisariatit, viktimë është shprehur së është larguar nga shtëpia bashkëshortore për shkak të debateve të përsëritura. Pas largimit, zonja është vendosur në banesën e prindërve por nuk ka gjetur mbështetje prej tyre dhe është detyruar të kthehet tek bashkëshorti dhunues. Pas rikthimit, debatet dhe dhuna psikologjike janë shtuar dhe përkeqësuar dhe ajo është larguar përsëri nga banesa, ku me ndërhyrjen e MKR Kamëz është akomoduar pranë Strehëzës Kombëtare të Dhunës.

Tabela 1. Numri i mbledhjeve të GTN-së ne vitin 2020 në Bashkinë Kamëz

Data	Mbledhjet e GTN-së
30.01.2020	Gjatë këtij takimi të mekanizmi janë trajtuar rastet e muajit dhjetor- janar. Janë trajtuar gjithsej 4 raste të dhunës në familje me problematikat kryesore dhe nevojat në vazhdim të secilit rast.
01.07.2020	Janë trajtuar rastet te muajit shkurt- mars. Gjithsej 8 raste të dhunës në familje
09.09.2020	Janë trajtuar raste të muajit prill- maj. Gjithsej 11 raste të trajtuara
28.10.2020	Janë trajtuar rastet e muajit qershor-korrik. Gjithsej 16 raste të trajtuara
15.12.2020	Janë trajtuar raste të muajve gusht-shtator-tetor. Gjithsej 15 raste të trajtuara

Burimi: Monitorim i drejtëpërdrejtë dhe Bashkia Kamëz

Tabela 2. Numri i mbledhjeve të KD-së në vitin 2020 në Bashkinë Kamëz

Data	Mbledhjet e GTN-së
02.12.2020	<i>Nënshkrimi i protokollit të menaxhimit të rasteve në kohë pandemike nga anëtarët e Komitetit Drejtues pranë Mekanizmit të Koordinuar të Referimit pranë bashkisë Kamëz.</i>

Burimi: Monitorim i drejtëpërdrejtë dhe Bashkia Kamëz

Sipas komunikimeve me Koordinatorin, me ndryshime të ndryshme të përfaqësuesve ligjor të institucioneve të ndryshme, përbërja e Komitetit Drejtues mbetet e paqartë.

Tabela 7. Përbërja e Komitetit Drejtues, Bashkia Kamëz Viti 2020

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2020
Bashkia	Kryetar Rakip Suli
Drejtoria e Policisë	Komisariati Policise nr.5 Kamëz, Altin Lila
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	----
Prokuroria e Rrethit	----
Drejtoria Arsimore	Zyra Arsimore Kamëz, z. Gentjan Murataj

Rajonale	
Drejtoria e Shëndetit Publik	-----
Drejtoria e Shërbimit Social	Qendra për viktimat e dhunës në familje, znj. Sonila Rec
Zyra e Përmbartimit	-----
Prefektura	-----
Zyra e Punësimit	Znj. Julinda Gjonaj
OSHC	-----
Dhoma e Avokatisë	-----
Shërbimi Shëndetësor	Qendra Shëndetësore Kamëz, z. Edmond Drici

Burimi: Bashkia Kamëz

Tabela 3. Përbërja e GTN-së, Bashkia Kamëz Viti 2020

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2020
Bashkia	Kordinatoria e dhunës në familje, Znj.Arjola Gjuta
Drejtoria e Policisë	Znj.Julinda Berisha
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	
Prokuroria e Rrethit	
Drejtoria Rajonale Arsimore	Z. Andon Andoni
Drejtoria e Shëndetit Publik	
Zyra e Përmbartimit	
Prefektura	
Kryetarët e Njësive Administrative	Ketu janë të përfshirë punonjëset për mbrojtjen e fëmijëve/ barazi gjinore nëpër njësitë përkatëse
Zyra e Punësimit	Z. Enes Haxhiu
Organizata Jo qeveritare	Znj. Ornela Saraci World Vision. znj. EjnXH Pepa, Linja e

	Këshillimit për vajza dhe gra,z. Taulant Gegolli Të ndryshëm të barabartë, znj. Margarita Begaj TLAS, znj. Gentjana Zeneli dhe znj. Milena Qerimaj QDNJD
Strehëzat për viktimat e dhunës	Znj. Redinela Haziraj
Komunitete fetare	Koordinatorja e dhunës në familje, znj.Arjola Gjuta
Dhoma e Avokatisë së Rrethit	Znj.Julinda Berisha

Burimi: Bashkia Kamëz

Objektivi 3.3: Ndëshkimi i dhunuesve dhe dhënia e mundësisë për rehabilitimin e tyre, përmes programeve të specializuara.

Gjykata e Rrethit Tiranë nuk bën ndarje statistikore të rasteve të lëshimit të Urdhra Mbrojtje (UM) dhe Urdhra të Menjëhershëm të Mbrojtjes (UMM) sipas bashkive, gjinisë apo moshës. Pranë kësaj gjykate mungon një zyrë e tillë dhe me gjithë rekomandimet ndër vite akoma nuk është ngritur.

Në këtë situatë për statistikën zyrtare të UM/UMM të mbërritura nga gjykata Tiranë për bashkinë Kamëz u mor për bazë informacioni i koordinatores së kësaj bashkie. Rezulton që pranë MKR Kamëz janë të regjistruar 120 Urdhra Mbrojtje dhe Urdhra të Menjëhershëm të Mbrojtjes.

Megjithëse nuk është pjesë e MKR, Shërbimi i Provës rezulton të jetë jo funksional edhe pse ligji parashikon që ky institucion dhe gjykata duhet të bashkëpunojnë në mënyrë të ngushtë për dhënien e dënimeve alternative për dhunuesit.

Pranë Bashkisë Kamëz nuk ka një program përsa i përket dhënies së mundësisë për rehabilitimin e dhunuesve nëpërmjet programeve të specializuara, ndaj edhe përsëritja e dhunës në familje ndodh shpesh pranë kësaj bashkie

Paralelisht, në territorin e kësaj bashkie nuk ka as organizata të shoqërisë civile të cilat mund të ofrojnë shërbime të ngjashme në lidhje me plotësimin e objektivit të tretë të strategjisë.

Konkluzione të rëndësishme

Mekanizmi i Koordinuar i Referimit pranë Bashkisë Kamëz, megjithë përpjekjet dhe angazhimin e koordinatores kundër dhunës, gjatë vitit 2020 nuk ka funksionuar si i plotë. Institucione si Zyra e Punësimit, Gjykata, Prokuroria, Drejtoria e Shëndetit Publik dhe Përmbarimi, janë pothuajse inekzistent në takimet e Ekipit Teknik Ndërdisciplinar, duke mos patur as përfaqësues stabël të këtij ekipi.

Komiteti Drejtues nuk funksionon si i plotë, duke qenë se që në krijimin e Mekanizmit të Referimit pranë kësaj bashkie vijon të ketë mungesa të institucioneve pjesë të marrëveshjes. Ndërgjegjësimi

I komunitetit për të mos pranuar dhunën në familje vijon të jetë pa mbështetje financiare nga bashkia e Kamzës, duke mos patur një zë të veçantë në buxhet, duke sjellë kështu mungesa të fushatave, ose duke u bazuar vetëm në ndihmën dhe fushatat që organizojnë organizatat e shoqërisë civile.

Megjithëse viti 2020 ishte i vështirë për shkak të pandemisë Covid-19, solli një mënyrë të re pune duke ofruar trajnime dhe workshope online, por anëtarët e MKR pranë kësaj bashkie, përveç koordinatorës kundër dhunës nuk rezultoi të kenë ndjekur trajnime të tilla, të përbashkëta.

Krahasuar me një vit më parë, MKR pranë kësaj bashkie ka arritur të menaxhojë 89 raste, viktimat të dhunës në familje, rreth 38 më shumë, por vetëm 1/3 e tyre mund të quhen raste suksesi, të cilat kanë marrë të gjitha shërbimet e nevojshme dhe të kërkuara.

Kontributi i Zyrës së Punës për ofrimin e mundësive reale për punësim për viktimat e dhunës në familje vijon të jetë në nivele mjaft të ulëta duke sjellë kështu një varësi të viktimave në ndihmën që jep pushteti vendor dhe organizatat dhe duke e larguar edhe më shumë ditën e pavarësisë ekonomike dhe ri-integrimit të plotë në shoqëri.

Rekomandime kryesore

Në bazë të monitorimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore në bashkinë e Kamzës për vitin 2020, më poshtë renditen disa rekomandime të cilat kërkojnë masa të menjëherëshme për të rregulluar funksionimin e Mekanizmit të Referimit kundër Dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Kamzë dhe adresimin e objektivit të tretë të SKBGJ, kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje:

- Rishikimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit pranë Bashkisë Kamzë dhe specifikimi dhe caktimi i përfaqësuesve të Komitetit Drejtues si edhe të atyre të Ekipit Teknik;
- Vendosja si zë në buxhetin e bashkisë të fondeve për organizimin e fushatave ndërgjigjesuese apo prodhimin e materialeve mbështetëse që qytetarët e kësaj bashkie të njihen me mekanizmat mbrojtës sa i përket dhunës në familje;
- Bashkia e Kamzës duhet të ketë komunikim të vazhdueshëm për marrjen e UM/UMM që i përkasin komunitetit të kësaj bashkie nga gjykata e rrethit Tiranë.
- Përmirësimi i mekanizmave dhe kapaciteteve profesionale nëpërmjet ofrimit të trajnimeve të vazhdueshme për stafin është një mundësi e mirë për bashkinë që të ofroj shërbime sa më koherente dhe me standarde.
- Duhet punuar më shumë në avancimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërinstitucional të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit me qëllim adresimin sa më të mirë të nevojave të rasteve të trajtuara;
- Marrja e masave për rritjen e llojit të shërbimeve dhe ngritja e tyre sa më afër vendbanimeve të viktimave;
- Rekomandohet një rritje e kontributit të Zyrës së Punës sa i përket ofrimit të mundësive për punësimin e viktimave të dhunës në familje;
- Rritje e kontributit të Komisarariatit të policisë sa i përket orientimit të viktimave/të mbijetuarve në lidhje me provat që duhet të paraqesin gjatë procesit të lëshimit të UMM/UM si dhe mbajtja nën vëzhgim e rasteve të pajisura me urdhër mbrojtje.
- Marrja e masave për shoqërimin e çdo rasti nga punonjësit e policisë pranë Qendrave Shëndetësore.

- Rishikimi dhe gjetja e mënyrave dhe formave për rehabilitimin e dhunuesve me programe të specializuara. Rekomandohet bashkëpunimi me Linjën për Djem dhe Burra me zyra kryesore në Tiranë.